

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6977
E mërkurë, 23 gusht 2023
Çmimi 0.40 €

Mitrovica e Veriut
anëtarësohet në
Asociacionin e
Komunave të Kosovës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", RRAHMAN JASHARAJ | FAQE 4-5

QEVERIA ËSHTË FAJTORE PËR DËSHTIMIN E MARRËVESHJES PËR LIBRAT



Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rahman Jasharaj, e ka fajësuar Ministrinë e Arsimit për dështimin e marrëveshjes për sigurimin e librave për nxënësit. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Jasharaj e ka quajtur ide të gabuar që prindërit të rimburohen për blerjen e librave të nxënësve. Në këtë kontekst, ai ka thënë se nxënësit do të mbesin në mëshirën e ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci dhe të ministrit të Financave, Hekuran Murati, duke thënë se familje të shumta janë në gjendje të rëndë ekonomike. Sipas Jasharajt, jo vetëm nxënësit, por edhe mësuesit do të hasin në vështirësi në fillim të vitit shkollor për shkak të mungesës së librave. Jasharaj e ka akuzuar Nagavcin edhe për mungesë të bashkëpunimit me SBASHK-un, duke thënë se ajo është duke vazhduar të mbajë inat që nga greva e kaluar e mësuesve.

OPOZITA
KËRKON
SHKARKIME PAS
PLANIT TË RI
PËR FURNIZIM
TË NXËNËSVE
ME TEKSTE
SHKOLLORE



FAQE 3

KURTI TAKON
HOMOLOGUN
GREK:
MARRËVESHJA
ME SERBINË
DUHET TË
ZBATOHET
E PLOTË DHE
PA KUSHTE




FAQE 5

RAMA UA JEP "ÇELËSIN E
QYTETIT" ISH-KONGRESISTIT JOE
DIOGUARDI DHE SHIRLEY CLOYES
DIOGUARDI F. 6

AKP-JA PËR 17 DITË MBLEDH MBI
GJYSMË MILION EURO BORXHE NGA
QIRAMARRËSIT F. 6

KLINIKAT, "REZERVA TË FUNDIT"
TË GJAKUT F. 7

EKONOMI



LËVIZJA FOL: QEVERIA REALIZOI
VETËM 60 AKTIVITETE PREJ 175
SA ISHIN PARAPARË NË PLANIN
KOMBËTAR PËR ZHVILLIM F. 8

DOGANA SHËNON NJË TJETËR
REKORD, MBLEDH 1 MILIARD EURO
F. 8

SPORT



DRILON HAZROLLAJ, 'YLLI I JAVËS'
NË SUPERLIGË F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rreth 500 fëmijë kanë vdekur nga uria që nga fillimi i luftës në Sudan

KARTUM, 22 GUSHT - Rreth 500 fëmijë kanë vdekur nga uria në Sudan, përfshirë dhjetëra foshnja në një jetimore të drejtuar nga qeveria në kryeqytetin Kartum - që nga prilli, kur shpërtheu lufta në vend, njoftoi të martën organizata "Save the Children". Gjithashtu, kjo organizatë bëri me dije se të paktën 31 000 fëmijë nuk kanë qasje në trajtime për kequshqyerje dhe sëmundje të lidhura me të, pasi organizata bamirëse u detyrua t'i mbyllte 57 nga qendrat e saj të ushqyerjes në Sudan.

Lufta në Sudan shpërtheu më 15 prill pas disa muajsh tensione mes ushtrisë dhe forcës rivale paraushtarake. Konflikti e ka kthyer Kartumin dhe zonat e tjera urbane në fushëbeteja. Shumë banorë jetojnë pa ujë dhe energji elektrike dhe sistemi i kujdesit shëndetësor të vendit pothuajse është shembur. "Asnjëherë nuk e kishim menduar se do të shihnim fëmijë që vdesin nga uria në shifra të tilla, por ky është tani realiteti në Sudan", tha Arif Noor, drejtor i selisë së "Save the Children" në Sudan. Nga dhuna në Sudan

vlerësohet të jenë vlarë të paktën 4 000 njerëz, sipas Liz Throssell, një zëdhënëse e Zyrës së OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Aktivistët dhe mjekët në terren, megjithatë, thonë se numri i të vdekurve ka të ngjarë të jetë shumë më i lartë.

Më shumë se 4.4 milionë njerëz u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre, të shkojnë në zona më të sigurta në Sudan ose të shpërngulen në vendet fqinje, sipas agjencisë së migracionit të OKB-së.

Organizata "Save the Children" tha se midis majit dhe korrikut, të paktën 316 fëmijë, kryesisht nën 5 vjeç, vdiqën nga kequshqyerja ose sëmundjet e lidhura me të në provincën jugore të Nilit të Bardhë. Më shumë se 2 400 fëmijë të tjerë janë pranuar në spitale në tetë muajt e fundit me kequshqyerje të rëndë akute - forma më vdekjeprurëse e kequshqyerjes. Në provincën lindore Qadarif të paktën 132 fëmijë vdiqën nga kequshqyerja në Spitalin e Fëmijëve të drejtuar nga qeveria midis prillit dhe korrikut.

Dhe të paktën 50 fëmijë, duke përfshirë dhjetëra foshnja, vdiqën nga uria ose sëmundjet e lidhura me të në një jetimore



në Kartum në gjashtë javët e para të konfliktit pasi luftimet penguan stafin e "Save the Children" të hynte në ndërtesë për t'u kujdesur për ta, tha kjo organizatë.

"Save the Children" paralajmëroi se furnizimet e veçanta ushqimore për trajtimin e kequshqyerjes po mbaronin në

mënyrë kritike në 108 objekte që ende operojnë në mbarë Sudanin.

Ndërkohë, përlëshjet janë ndezur këtë javë rreth një kampi ushtarak në jug të Kartumit, ndërsa Forcat e Mbështetjes së Shpejtë paraushtarake janë përpjekur të marrin në dorë këtë objekt me rëndësi

strategjike, raportuan palët ndërluftuese.

Beteja të ashpra u raportuan javën e kaluar në Nyala, kryeqytetin provincial të Darfurit Jugor. Rajoni i Darfurit kishte disa nga periudhat më të këqija të dhunës, pasi që luftimet u kthyen në përlëshje etnike.

Ministrja gjermane: Kina po e sfidon mënyrën se si jetojmë së bashku në botë



BERLIN, 22 GUSHT - Ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, tha më 22 gusht se Kina paraqet një sfidë për "themelet e mënyrës se si jetojmë së bashku në këtë botë" dhe shtoi se Gjermania do të punonte me vendet si Australia për t'u ulur tensionet në rajonin Indo-Paqësor.

Në një adresim për një institut australian të politikës së jashtme, Baerbock tha se përvoja e Australisë me kufizimet tregtare

të vendosura nga Kina ka ndikuar që Gjermania t'i ndërrojë politikat ndaj Pekinit. "Kina ka ndryshuar dhe kjo është arsyeja pse politika jonë ndaj Kinës gjithashtu duhet të ndryshojë", i tha ajo institutit Lowy.

Përderisa tha se Kina është vend partneri në çështjet si për ndryshime klimatike dhe tregti, ajo ishte "një rivale kur bëhet fjalë për themelet e mënyrës se si ne jetojmë së bashku në këtë botë",

tha ajo. "Ajo që ne shohim është shfaqja e një bote ku po rritet rivaliteti sistematik, ku disa regjime autokratike kërkojnë ta ndryshojnë rendin ndërkombëtar për t'i rritur sferat e tyre të ndikimit, duke përdorur jo vetëm fuqinë ushtarake, por edhe ndikimin ekonomik", shtoi Baerbock. Ajo tha se shumë vende po i afrohen Kinës sepse atyre u mungojnë alternativat dhe shtoi se Gjermania dëshiron ta ndryshojë këtë gjë. Sipas saj,

Gjermania nuk do ta bëjë këtë duke promovuar konfrontim të ri midis blloqeve, por duke diversifikuar partnerët e saj tregtarë. "Ne mësuam se sa të cenueshëm na bëri varësia jonë e njëanshme nga importet ruse të energjisë. Ne nuk duam ta përsërisim atë gabim", tha ajo. Duke theksuar rëndësinë ekonomike të rajonit Indo-Paqësor për Evropën, Baerbock tha se gjysma e të gjitha anijeve me kontejnerë kalojnë nëpër

ngushticën e Tajvanit. "Çdo ndryshim i njëanshëm në status quon përgjatë ngushticës së Tajvanit do të ishte i papranueshëm, aq më tepër nëse kjo do të përfshinte mjete shtrënguese ose ushtarake", shtoi ajo.

Gjermania mori pjesë në stërvitjet ushtarake 13-vendëshe Talisman Saber në Australi muajin e kaluar dhe hapi ambasadën e saj të parë në Ishujt e Paqësorit në Fixhi më 19 gusht.

Opozita kërkon shkarkime pas planit të ri për furnizim të nxënësve me tekste shkollore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 GUSHT - Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e kanë kritikuar Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Qeverinë e Kosovës lidhur me planin e ri të shpërndarjes së teksteve shkollore për fëmijët. LDK-ja ka kërkuar dorëheqjen e ministres Arbërie Nagavci shkaku i asaj që e ka cilësuar si "keqmenaxhim i vitit shkollor", ndërsa AAK-ja ka kërkuar rrëzimin e Qeverisë së Kosovës. "Kosova nuk e meriton një ministere që ka dështuar në çdo nivel ta menaxhojë arsimin dhe përfundimisht është dorëzuar duke ua kaluar përgjegjësinë prindërve", ka thënë kryetarja e Forumit të Gruas në LDK, Jehona Lushaku, në një konferencë për medie mbajtur më 22 gusht.

Një ditë më parë ministrja Nagavci tha se MASHTI po e shqyrton mundësinë që t'ua transferojë paratë prindërve në mënyrë që ata t'i blejnë vetë tekste shkollore për fëmijët e tyre për vitin e ri shkollor. Në të kaluarën MASHTI i ka blerë tekste nga shtëpitë botuese e ato pastaj u janë shpërndarë nxënësve nëpër shkolla.

Në konferencë Lushaku e ka kritikuar këtë plan të MASHTI-t dhe ka shprehur shqetësim që planifikimi për vitin e ri shkollor, që nis më 1 shtator, nuk është bërë më herët. "Përveç paaftësisë së qeverisë për menaxhim të kësaj situatë, kjo qeveri me këtë vendim i ka ikur përgjegjësisë, duke i ngarkuar prindërit dhe duke

shkelur ligjin në fuqi", ka thënë Lushaku.

Duke folur për arsyet e këtij plani të ri një ditë më parë, Nagavci ka përmendur keqpërdorimet financiare dhe ka thënë se ka pasur edhe raste të cilat MASHTI i ka adresuar tek organet e hetuesisë. "Kemi pasur raste kur një tekst një vit është shitur tri euro, pastaj në vitin vijues mbi 12 euro. Ka pasur dallime tepër të mëdha të çmimeve të teksteve shkollore. Kemi pasur jo vetëm dallim nga viti në vit, por edhe dallime për tekstet e së njëjtës klasë nga shtëpitë e ndryshme botuese me çmime", ka treguar ajo.

Por, Lushaku thotë se qeveria nuk do të kursejë para përmes këtij plani të ri, por "do të dëshmohej se blerja me pakicë e librave do të shkaktojë kosto më të lartë për buxhetin e shtetit tonë". "Përfundimisht, qeveria do ta paguajë më shtrenjtë rimbursimin e prindërve sesa t'i blinte vetë librat", ka bërë me dije ajo, duke shtuar se kostoja mund ta kalojë shifrën prej dy milionë eurosh, sa është paraparë të shpenzohet për furnizim me libra.

Në një tjetër konferencë për medie, shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se ky plan i MASHTI-t do të provokojë greva në arsim. "Kjo situatë mund të përfundojë vetëm me shkarkimin e kësaj qeverie. Kjo qeveri është duke e dëmtuar Kosovën në rrafshin ndërkombëtar, të brendshëm, politik dhe ekonomik. Vendimi i MASHTI-t, për refuzimin për t'i siguruar librat për nxënësit, është edhe një fakt që kjo qeveri nuk ka synim t'i ndihmojë njerëzit. Ky vendim ka qëllim krijimin edhe të një krize të re



për ta dëmtuar buxhetin e shumë familjeve", ka thënë Tahiri. Ai ka kërkuar rrëzimin e Qeverisë së Kosovës në një seancë të jashtëzakonshme në Kuvendin e Kosovës në fillim të shtatorit, duke përmendur si arsye edhe dyshimet për keqpërdorime të rezervave shtetërore.

Ndërkaq drejtorët e arsimit nga radhët e PDK-së në nivel komunal kanë mbajtur konferencë për medie, në të cilën kanë shprehur pakënaqësinë lidhur me propozimin e fundit të ministres së Arsimit, Arbërie

Nagavci, rreth furnizimeve me tekste shkollore për nxënës.

Besianë Musmurati, drejtoreshë e Arsimit në komunën e Prishtinës, ka thënë se "çdo ditë e më shumë po shohim që qeveria dhe Ministria e Arsimit janë të paafta të çojnë përpara çfarëdolloj politike arsimore". Sipas saj, propozimi i ri i kësaj ministrie për rimbursimin e prindërve për blerjen e librave është shembulli i fundit dhe më i freskët i keq-qeverisjes në arsim ashtu si në sektorët e tjerë. "Tentativat për të fshehur dështimin në arsim, me arsyetime dhe fshehje pas

gabimeve të së kaluarës, duhet të marrin fund. Gabimet nuk përmirësohen me gabime më të mëdha. Prindërit gjithandej Kosovës janë tejet të shqetësuar me situatën e re e cila pritet të krijohet. Edhe shtatori i dytë nën qeverisjen Kurti po i gjënë nxënësit me probleme për ta nisur vitin shkollor", ka thënë Musmurati. Ajo ka shtuar se mbi 300 mijë familje do të detyrohen t'i blejnë librat për fëmijët e tyre, të pasigurt nëse ndonjëherë do t'u rimbursohen ato të holla, apo nëse ato do të jenë të mjaftueshme për t'i blerë librat.

"Ukraina duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës", thotë deputeti ukrainas



PRISHTINË, 22 GUSHT - Deputeti ukrainas Oleksiy Goncharenko ka komentuar takimin e presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky, me presidentin serb Aleksandar Vučić në Athinë.

Goncharenko deklaroi sot se Ukraina duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës. Këtë mendim ai e ka shprehur në platformën "X". Ai ka thënë se Serbia është aleate e Rusisë dhe se Ukraina nuk mund ta tërheqë në anën e saj. "Zelensky u takua me presidentin e Serbisë. Serbia është aleate e Rusisë. Ne nuk do të mund ta tërheqim Serbinë në anën tonë. Kjo nuk është për shkak se ne jemi

shumë të këqij, por sepse popullsia e Serbisë mbështet Rusinë me shumicë të pabesueshme. A duhet të takohemi atëherë? Po, sigurisht. A duhet të kompromentojmë parimet tona? Jo. Ukraina duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës", ka shkruar ai.

Vučići, pas takimit me Zelenskyn, ka thënë se kanë folur edhe për situatën në Kosovë. "Ia shpjegova situatën rreth Kosovës. Nuk mendoj se do të ketë ndonjë ndryshim në pozicionin e Ukrainës në lidhje me integritetin tonë territorial. Ne e mbështetëm Ukrainën në rrugën e saj evropiane", ka thënë Vučići.



FLET PËR "EPOKËN E RE", RRAHMAN JASHARAJ

Qeveria është fajtore për dështimin e marrëveshjes për librat

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rahman Jasharaj, e ka fajësuar Ministrinë e Arsimit për dështimin e marrëveshjes për sigurimin e librave për nxënësit. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Jasharaj e ka quajtur ide të gabuar që prindërit të rimburohen për blerjen e librave të nxënësve. Në këtë kontekst, ai ka thënë se nxënësit do të mbesin në mëshirën e ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci dhe të ministrit të Financave, Hekuran Murati, duke thënë se familje të shumta janë në gjendje të rëndë ekonomike. Sipas Jasharajt, jo vetëm nxënësit, por edhe mësimdhënësit do të hasin në vështirësi në fillim të vitit shkollor për shkak të mungesës së librave. Jasharaj e ka akuzuar Nagavcin edhe për mungesë të bashkëpunimit me SBASHK-un, duke thënë se ajo është duke vazhduar të mbajë inat që nga greva e kaluar e mësimdhënësve

"Epoka e re": Pse mendoni se ka dështuar kjo marrëveshje?

Jasharaj: Ka kohë që ministrja Nagavci u ikën takimeve me përfaqësuesit e SBASHK-ut. Sa kam parë, ajo takimeve dhe konsultimeve po u ik edhe me të tjerët dhe po sjell vendime të njëanshme e të paanalizuara mirë. Nuk di pse ka dështuar marrëveshja me botuesit sepse nuk kemi pasur asnjë takim me ministren Nagavci dhe nuk kemi pasur mundësi të bashkëbisedojmë për as edhe një çështje që lidhet me sistemin arsimor në Kosovë. Ministrja Nagavci duhet ta thotë të vërtetën lidhur me këtë dhe nëse do që t'i fajësojë shtëpitë botuese që gjoja paskan ngritur shumë çmimet e teksteve shkollore, atëherë t'i botojë kërkesat e tyre për këto ngritje çmimesh. Tekefundit, edhe ngase ka ndodhur kjo, prapë ministrja e ka përgjegjësinë dhe ministrja bashkë me qeverinë është dashur të gjejnë mjete shtesë e të paguhen teksteve shkollore në mënyrë që ato të shpërndahen me kohë. Tani kemi një fillim të vitit të ri shkollor, fatmirësisht pa greva, por me mungesë të

teksteve shkollore, që janë, fatkeqësisht, mjete të vetëm i punës në procesin mësimor bashkë me shkurtesat e shpuza. Nëse qeveria Kurti nuk ka buxhet për mjete bashkëkohore mësimore, atëherë bile për tekste të reja shkollore për nxënësit që nga klasa e parë e deri për ata në klasën e nëntë është dashur të ketë.

"Epoka e re": Pas dështimit të kësaj marrëveshjeje, ministria Nagavci ka bërë me dije se janë duke e shqyrtuar mundësinë që transferimi i mjeteve për sigurimin e teksteve shkollore të kalojë në llogaritë e prindërve. A shihni seriozitetin në këtë çështje duke pasur parasysh se mësimi pritet të fillojë më 1 shtator?

Jasharaj: Kjo është ide tepër e gabuar e ministres Nagavci. Ajo ka deklaruar para medieve se disa nga tekstet kanë çmime tepër të larta dhe se ajo po angazhohet ta ruajë buxhetin e shtetit, nga ana tjetër u thotë prindërve blini ju tekstet e pastaj qeveria do t'ju rimburojë pas aplikimit në e-Kosova. Nagavci duhet ta dijë se në Kosovë një pjesë e madhe e

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 22 GUSHT -

"Epoka e re": Z. Jasharaj, komenti juaj për dështimin e Ministrisë së Arsimit që të arrijë marrëveshje me shtëpitë botuese për tekstet shkollore?

Jasharaj: Ministrja Nagavci në konferencën për medie para një jave kishte deklaruar se Ministria e Arsimit do të sigurojë tekste falas për nxënësit e klasave 1-5, ndërsa

për nxënësit e klasave 6-9 shkollat duhet të gjenden me testet shkollore të vjetra, pra që janë përdorur në vitin e kaluar shkollor. SBASHK-u E ka kundërshtuar këtë deklaram të ministres lidhur me tekstet shkollore të vitit të kaluar sepse ato janë të përdoruara nga nxënësit dhe dukshëm të dëmtuara, kurse fletoret e punës janë të plotësuara nga nxënës të vitit të kaluar. Në konferencën e djeshme për medie Nagavci doli me një lajm

edhe më të keq, duke i kritikuar shtëpitë botuese për çmimet e larta të teksteve shkollore e duke dhënë idenë shumë të gabuar që prindërit t'i blejnë tekstet shkollore për fëmijët e tyre në librari e pastaj ministria, pas aplikimit që prindërit bëjnë në e-Kosova, t'ua rimburojë ato para. Kjo nuk është në rregull, sepse një numër i madh i familjeve jetojnë në gjendje të vështirë ekonomike dhe nuk kanë para për të blerë tekste shkollore.

Kurti takon homologun grek: Marrëveshja me Serbinë duhet të zbatohet e plotë dhe pa kushte

Athinë, 22 gusht - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është pritur të martën në Athinë nga kryeministri i Greqisë, Kyriakos Mitsotakis, në pallatin Maximos, me të cilin ka pasur një takim dypalësh. Kryeministri Kurti e ka uruar homologun grek, Mitsotakis, për rizgjedhjen kryeministër dhe mandatin e ri qeveritar, duke i ofruar bashkëpunim të ngushtë për tema të interesit të përbashkët. Siç bëhet me dije në njoftimin për medie të zyrës së tij, kryeministri Kurti ka thënë se Kosova dhe Greqia gëzojnë marrëdhënie të mira të cilat po përmirësohen vazhdimisht në rrafshin ekonomik përmes rritjes së shkëmbimeve tregtare dhe në rrafshin politik përmes vizitave të shpeshta të krerëve të institucioneve të të dy shteteve. Ai e ka falënderuar kryeministrin Mitsotakis për ftesën dhe për darkën e mbrëmshme në të cilën ishin të pranishëm liderët e Ballkanit Perëndimor si dhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy, kryeministri i Kroacisë, Andrej Plenkovic, kryeministri i



Rumanisë Marcel Ciolacu, kryeministri i Bullgarisë Nikolai Denkov, dhe presidentja e Moldavisë, Maia Sandu. Në këtë takim Kurti e Mitsotakis kanë biseduar edhe për dialogun në Bruksel dhe bashkëpunimin rajonal. Kryeministri Kurti ka thënë që tashmë është një marrëveshje

porse nevojitet zbatim i plotë i saj dhe pa kushtëzime. Ai tregoi se pas pajtimi në Bratislavë po bëhen dy muaj pa asnjë incident e protestë të dhunshme në katër komunat në veri të Kosovës. "Pra kemi një situatë të de- eskaluar. Fokusi duhet të jetë te parandalimi i rrieskalimit nga elementë të dhunshëm", citohet

të ketë thënë Kurti.

Kryeministri Mitsotakis e falënderoi për pjesëmarrjen në darkë kryeministrin Kurti dhe tha se është i interesuar t'i forcojë lidhjet ekonomike teksa shprehu interesim për sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Kryeministri Kurti veçoi rritjen ekonomike për çerekun e parë

të këtij viti që qëndron në 3,9 për qind dhe rënien e shkallës së inflacionit nga 11,9 për qind sa ishte në janar, në 2,8 për qind në qershor si dhe progresin në indikatorët e demokracisë. "Tha se me strategjinë e re për energjinë, qeveria është zotuar që gjenerimet e reja në energji të jenë nga burimet e ripërtëritshme, pra solare dhe nga era. Përmendi sektorët në rritje të prodhimit të ekonomisë sikurse atë të përpunimit të metaleve dhe të drurit, tekstilit, ushqimit dhe pijeve si dhe sektorin e shërbimeve dhe teknologjisë informative", bëhet me dije në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

Kryeministri Kurti e ftoi kryeministrin Mitsotakis për vizitë dhe për më shumë investime në Kosovë. Shkëmbimi tregtar me Greqinë vitin e kaluar ishte 308 milionë euro, një rritje mbi 40 për qind apo afër 100 milionë euro krahasuar më 2021.

Gjersa shprehu keqardhjen për zjarret që kanë përfshirë një pjesë të Greqisë, kryeministri Kurti ofroi ndihmën e Republikës së Kosovës për përbalimin me zjarret përmes njësiteve të kërkim-shpëtimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës.

familjeve kanë gjendje të vështirë ekonomike dhe prindërit do ta kenë shumë të vështirë t'i blejnë tekstet shkollore për gjithë fëmijët që kanë, e ta presin pastaj mëshirën e Nagavci e Muratit që t'u rimbursohen mjetet që kanë shpenzuar për blerjen e teksteve shkollore. Pse të bëjnë rimbursime e t'i vënë në siklet prindërit kur ato para të rimbursimit mund t'i përdorë MASHTI për të blerë tekste e t'i shpërndarë në shkollat e Kosovës?

"Epoka e re": A ka rrezik të dështojë fillimi i mësimin më 1 shtator duke e njohur gjendjen ekonomike të prindërve, pasi ende nuk dihen procedurat se si do të transferohen mjetet për blerjen e librave?

Jasharaj: Viti i ri shkollor do të fillojë dhe në klasë do të kemi nxënësit dhe mësimdhënësit, por do të ketë vështirësi sepse do të duhen ditë, mos të them edhe javë, që të gjithë nxënësit të kenë tekste shkollore që duhet t'ua blejnë prindërit. Kjo është sfidë sepse mësimdhënësit e kanë vështirë të realizojnë njësi të reja mësimore e të japin detyra të shtëpisë kur nxënësit nuk kanë tekste shkollore.

"Epoka e re": Z. Jasharaj, çfarë bashkëpunimi keni sot me Ministrinë e Arsimit, me ministren Nagavci?

Jasharaj: Fatkeqësisht, me fajin e ministres Nagavci, mungon

tani e sa kohë bashkëpunimi mes MASHTI-t dhe SBASHK-ut, bashkëpunim ky që dikur ka qenë në nivel të lartë dhe në shërbim të arsimit në Kosovë. Nga greva e shtatorit e këndej zonja Nagavci vazhdon të mbajë inat dhe nuk u është përgjigjur kërkesave tona për takime, të cilat dikur ia kemi bërë. Kabineti i saj është arsyetuar se gjoja ministrja ka shumë angazhime brenda dhe jashtë vendit dhe kështu u ka ikur takimeve.

"Epoka e re": Pra ajo nuk konsultohet me ju për ndonjë çështje që ka të bëjë me arsimin?

Jasharaj: Jo, nuk është konsultuar. Nuk ka pasur gatishmëri të takohet me ne tani e sa muaj, duke e prishur kështu traditën e mirë të takimeve, jo vetëm me SBASHK-un, por edhe me të tjerët, për të debatuar sinqerisht për të gjitha çështjet në arsim e për t'u marrë vesh për angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit. Pse është kjo situatë, fajtori i vetëm është zonja Nagavci, së cilës, si duket, nuk po i ikën inati i krijuar që nga greva e vitit të kaluar.

"Epoka e re": Pas grevës së përgjithshme, a keni pasur ndonjë kërkesë për Ministrinë e Arsimit dhe a është marrë parasysh nga kjo ministri?

Jasharaj: Në mungesë të takimeve, angazhimet dhe



kërkesat e anëtarësisë do t'i adresojmë përmes shkresave. Po përmes shkresave do ta informojmë për çështjet e ngritura nga anëtarësia jonë. Për të njoftuar opinionin për

angazhimet tona e vërejtjet ndaj MASHTI-t dhe vendimeve të caktuara të njëanshme, i kemi bërë publike përmes medieve dhe ne do t'i vazhdojmë angazhimet në shërbim të

anëtarësisë sonë, të cilën e falënderoj për unitetin dhe për ruajtjen e besimit të ndërsjellë që e kemi krijuar ne stafi udhëheqës me anëtarësinë në rrugëtimin tonë tani e sa vite.

Totaj nis fushatën “E du Prizrenin”

PRIZREN, 22 GUSHT - Kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka lansuar një fushatë për promovimin e aseteve të trashëgimisë kulturore të këtij qyteti. E titulluar “E du Prizrenin”, fushata synon ta promovojë qytetin dhe trashëgiminë e Prizrenit në sytë e vizitorëve dhe turistëve të huaj. “Bëhuni gati për të nisur një udhëtim nëpër kohë teksa e nisim fushatën e promovimit të trashëgimisë kulturore të qytetit. Qyteti ynë është i zhytur në histori, art dhe tradita që kanë formësuar atë që jemi sot. Bashkohuni me ne për ta promovuar trashëgiminë tonë të pasur kulturore dhe potencialin e tanishëm të zhvillimit të një qyteti që bashkëjeton me të kaluarën

dhe të ardhmen! ‘E du Prizrenin’ është slogani i kësaj fushate që qëllim ka promovimin e qytetit tonë në sytë e vizitorëve”, ka shkruar ai në “Facebook”. Kjo fushatë mbështetet nga komuna e Prizrenit dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë (UNDP) dhe ka për qëllim t’i nxitë vizitorët të postojnë më shumë në rrjetet sociale për asetet historike duke i vizituar ato. Ata duhet të kyçen përmes faqes www.eduprizrenin.com e të mësojnë më shumë për historikun e aseteve të çmuara të Prizrenit, edhe për lokacionet historike ku do të kyçen përmes QR code të vendosur në tabelat informuese.



Rama u jep “Çelësin e Qytetit” ish-kongresistit Joe DioGuardi dhe Shirley Cloyes DioGuardi

Prishtinë, 22 gusht - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, u ka dhënë “Çelësin e Qytetit” ish-kongresistit Joe DioGuardi dhe Shirley Cloyes DioGuardi

nga Liga shqiptaro-amerikane. Kryetari Rama u shprehi mirënjohje për kontributin dhënë Kosovës në situata kombëtare. Kryetari Rama tha

se dyert e qytetit të Prishtinës janë të hapura, ashtu siç kanë qenë edhe zemrat e tyre në kohën kur populli shqiptar ka vuajtur.

AKP-ja për 17 ditë mbledh mbi gjysmë milion euro borxhe nga qiramarrësit

PRISHTINË, 22 GUSHT - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme, në të cilën ka diskutuar në lidhje me inkasimin e të hyrave nga qiratë pas vendimit që kishte marrë në takimin e fundit që të gjithë qiramarrësit pa dallim të dërgohen në përmbarim nëse nuk u përmbahen obligimeve kontraktuale të qirasë. Si rrjedhojë, vetëm gjatë këtij muaji (nga data 1 deri me datë 17 gusht) AKP-ja ka arritur të inkasojë vlerën e përgjithshme monetare të borxhit për të gjithë qiramarrësit e NSh-ve në shumën 524 mijë e 334 euro, që është rezultat i krijimit të një discipline të qiramarrësit. “Vlen të

përmendet se një shumë e konsiderueshme e borxhit është arritur të inkasohet nga qiramarrësit e hapësirave në ‘Grand Hotel’. Vetëm për pjesën e parë të këtij muaji janë inkasuar 167 234 euro nga qiramarrësit, ndërsa po të llogaritet edhe muaji paraprak (korriku), Agjencia ka inkasuar borxhe të papaguara nga qiramarrësit në ‘Grand Hotel’ 263 mijë euro”, ka njoftuar AKP-ja. Bordi i Drejtorëve ka kërkuar nga menaxhmenti mbikëqyrje rigorozë e respektim të obligimeve kontraktuale e ligjore pa lëshime e pa dallime. “Në këtë frymë, Agjencia ka iniciuar një numër të qiramarrësve në përmbarim dhe ndërprerje të



kontratës si pasojë e mosshlyerjes së borxheve dhe shkeljeve të kontratave me AKP-në dhe do të veprohet njëjtë me të gjithë qiramarrësit e papërgjegjshëm”, theksohet në

njoftimin për medie. Për më tepër, Bordi ka diskutuar edhe në lidhje me procesin e rivlerësimit të qirave për pronat e ndërmarrjeve shoqërore, me qëllim që çmimet e qirave të jenë

sa më të përafërta me çmimet e tregut. “Vetëm në takimin e fundit Bordi ka miratuar vlerësimin e 73 qirave me një rritje mesatare prej 37-përqindësh të çmimit të qirasë dhe ka kërkuar nga menaxhmenti që deri në fund të muajit tjetër të bëhet rivlerësimi i çmimeve të qirasë për të gjithë qiramarrësit në mënyrë që këto çmime të jenë sa më të përafërta me çmimet e tregut. Përfundimisht, Bordi miratoi edhe 21 qira të reja (të patenderuara më parë) përmes një procesi të hapur dhe transparent dhe me qëllim të shfrytëzimit sa më racional të pronave që ka nën menaxhim”, ka njoftuar AKP-ja.

Një rrugë apo institucion publik në Mitrovicë do të emërtohet “Bajram Rexhepi”



MITROVICË, 22 GUSHT - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, së bashku me drejtorë komunalë dhe drejtues të Shoqatave të Dala nga Lufta, ka bërë homazhe të varri i ish-kryeministrit Bajram Rexhepi në gjashtëvjetorin e vdekjes së tij. Me këtë rast, kryetari Hamza ka thënë se në gjashtëvjetorin e kalimit në amshim të Bajram Rexhepit, dëshiroj të vë në pah kontributin e tij të çmuar të dhënë për Kosovën, të cilën e

udhëhoqi me përgjegjësinë më të lartë si kryeministër i parë i Kosovës, në veçanti për angazhimin e tij të dhënë për Mitrovicën sa ishte kryetar komune. Më tutje, kryetari Hamza ka theksuar se Rexhepi ishte kontribuues i madh në shumë rrjedha dhe zhvillime që kanë ndodhur në Kosovë gjatë luftës çlirimtare, si pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). “Mitrovica dhe e tërë Kosova

gjithmonë do të krenohen me punën dhe veprat e ish-kryeministrit Bajram Rexhepi, i cili ka dhënë shembull të mirë si udhëhiqet një shtet dhe se si punohet për interesin e të gjithë qytetarëve. Qoftë i përjetshëm kujtimi për të!”, është shprehur Hamza. Me propozim të kryetarit Hamza, në shenjë mirënjohje dhe falënderimi, një rrugë apo institucion publik do të emërtohet “Bajram Rexhepi”.

Klinikat, “rezerva të fundit” të gjakut

Prishtinë, 22 gusht - Pavarësisht prej vapës së madhe, në mesditën e 21 gushtit Nezir Gerbeshi priste para Qendrës së Transfuzionit të Gjakut në Prishtinë për të dhuruar gjak. Pensionisti 64-vjeçar ka dhuruar gjak 128 herë gjatë jetës. Shumë herë është ofruar vetë, por në shumë raste është ftuar edhe nga autoritetet shëndetësore. “Mbi 40 herë më kanë ftuar këta të qendrës, sidomos për trombocite. Sot kam ardhur sepse kam dëgjuar se ka mungesë të gjakut në transfuzion”, rrëfeu ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Po atë ditë në Klinikën e Ortopedisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës REL-i bisedoi edhe me Hajdin Podvoricën, i cili sapo kishte dhuruar gjak për një familjar të vetin. “Më thanë se duhet të vij këtu dhe të jap gjak se nuk ka”, tha 51-vjeçari.

Zyrtarë të Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut (QKKTGJ) e konfirmojnë këtë mungesë, duke thënë se aktualisht po operojnë me “rezervat e fundit”. “Deri te mungesat e llojeve të grupeve të gjakut ka ardhur pas kërkesave të mëdha nga klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, sidomos nga Klinika Emergjente”, thotë për “Radion Evropa e Lirë” Albana Gashi, zyrtarë për promovimin e dhurimit të gjakut në QKKTGJ. Sipas saj, mungesa e një numri më të madh të dhuruesve të gjakut ka ndikuar, po ashtu, që



të mos ketë sasi të bollshme. Mungesat theksohen shpesh gjatë muajve të verës, kur qytetarët - dhurues potencialë të gjakut - janë në pushime, ndërsa aktivitetet në ambiente të jashtme janë më intensive. Por, disa mjekë thonë se ky sezon është ndër më të rëndët. Merita Morina-Bujupi, doktoreshë në QKKTGJ, thotë se shumë raste të rënda shëndetësore që janë trajtuar në QKUK janë shkaktuar nga aksidentet në trafik apo qitjet me armë.

Shumica prej tyre kanë pasur

nevojë për gjak. “Kemi pasur raste urgjente, të cilat kanë kërkuar doza të mëdha të gjakut. Një rast mund të nisë me 2, 3 apo 4 doza [dhe të përfundojë] me 30 apo 40”, thotë Morina-Bujupi.

Sasia e dozave mund të shkojë deri në 300-400 mililitra.

Në QKKTGJ nuk tregojnë se sa doza do ta stabilizonin gjendjen, apo sa janë të nevojshme mesatarisht në një vit, por thonë se vazhdimisht organizojnë aktivitete për grumbullimin e gjakut.

Aty pohojnë se numri i

dhuruesve është në rritje nga viti në vit, por theksojnë se edhe kërkesat janë të mëdha.

Njazi Sherifi brenda dhjetë ditësh ka marrë tetë doza gjaku.

I shtrirë në Klinikën e Gastroenterologjisë të QKUK-së, ai thotë se familjarët e tij nuk kanë mundur të dhurojnë gjak dhe se dozat që i janë dashur, ia ka siguruar spitali. “Fillimisht kam marrë tri doza, pastaj edhe tri, e kështu me radhë. Tash po ndihem më mirë. Gjakut që kam marrë ma ka shpëtuar jetën... Unë kështu mendoj”, thotë Sherifi, i cili vjen nga komuna e

Ferizajt.

Autoritetet shëndetësore thonë se dozat më të mëdha të gjakut i thith Klinika Emergjente e QKUK-së.

Sipas një raporti që ka siguruar REL-i prej tyre, në këtë klinikë gjatë gjithë muajit korrik deri më 21 gusht janë trajtuar 1 213 raste. Shumica prej tyre kanë pasur nevojë për një ose disa doza gjaku.

Rreth 90 për qind e nevojave të pacientëve për gjak në institucionet publike shëndetësore të Kosovës plotësohen nga dhuruesit vullnetarë të gjakut, përkatësisht nga QKKTGJ-ja, ndërsa pjesën tjetër e mbulojnë familjarët e pacientëve.

Dhurimi i një doze gjaku zgjat rreth 15 minuta. Sipas mjekëve, burrat dhe gratë në moshë jofertile mund të dhurojnë gjak çdo tre muaj, ndërsa gratë në moshë fertile mund të dhurojnë dy herë në vit.

Përveç gjakut, mund të dhurohen edhe përbërës të veçantë të tij si, për shembull, trombocite.

Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon që të gjitha dhurimet e gjakut të kontrollohen për infeksione përpara se të përdoren. “Transfuzioni i gjakut shpëton jetë dhe përmirëson shëndetin... Sigurimi i gjakut të sigurt dhe adekuat duhet të jetë pjesë integrale e politikës dhe infrastrukturës kombëtare të kujdesit shëndetësor të çdo vendi”, thekson OBSH-ja.

Mitrovica e Veriut anëtarësohet në Asociacionin e Komunave të Kosovës

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

MITROVICË E VERIUT, 22 GUSHT - Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës të martën është bërë anëtarësimi i Komunës së Mitrovicës së Veriut në Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK).

Votimi për anëtarësimin e Mitrovicës së Veriut në AKK ka kaluar me votat e të gjithë delegatëve të Kuvendit dhe ka ardhur pas kërkesës së Komunës së Mitrovicës së Veriut e cila ka marrë vendim në Kuvendin e Komunës për t'u anëtarësuar në Asociacion.

Kryetari i AKK-së, Agim Aliu, në fjalën e tij tha se “ky është Kuvend i jashtëzakonshëm i cili ka ardhur pas kërkesës së Komunës së Mitrovicës së Veriut për anëtarësim në Asociacionin e Komunave të Kosovës”.

Asociacioni i Komunave të Kosovës është themeluar më 30 qershor 2001 pas zgjedhjeve të



para lokale e demokratike pas luftës së fundit në Kosovë.

Nga 38 komuna sa ka Kosova, 34 prej tyre janë anëtare në Asociacionin e Komunave të

Kosovës, të cilat marrin pjesë në aktivitete, japin ide dhe sugjerime, marrin pjesë në gjitha strukturat e Asociacionit që nga Kuvendi, Bordi, Këshilli i

Kryetarëve dhe Kolegjiunet Profesionale.

Po ashtu, komunat anëtare marrin shërbime, projekte e zhvillim të kapaciteteve nga

Asociacioni i Komunave dhe Qendra e Trajnimit brenda Asociacionit.

Anëtarësimin e një komune në Asociacion e bën Kuvendi i AKK-së me shumicën e votave, dhe pas kërkesës së një komune, e cila bën kërkesë pas vendimit të Kuvendit të Komunës përkatëse, ku shpreh interesim, dëshirë dhe nevojë për anëtarësim në Asociacionin e Komunave të Kosovës. “E tillë është edhe kërkesa e Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe kërkoj nga ju që sot të shqyrtojme këtë kërkesë dhe të vendosim me anë të votimit për anëtarësim të Mitrovicës së Veriut në Asociacionin e Komunave të Kosovës”, ka thënë Aliu.

Pas anëtarësimit, kryetari i komunës së Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq, në fjalën e tij tha se është i lumtur për këtë anëtarësim, për çka falënderoi delegatët e Kuvendit të Asociacionit dhe tha se do ta japin kontributin e tyre në sfidat dhe adresimet e qeverisjes lokale në nivel vendi.

Lëvizja Fol: Qeveria realizoi vetëm 60 aktivitete nga 175 sa ishin paraparë në Planin Kombëtar për Zhvillim

Lëvizja Fol ka publikuar të dhënat nga monitorimi i zbatimit të aktiviteteve të parapara të përfundojnë në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Gjithashtu, ajo ka bërë një analizë të shkurtër të përmbajtjes së Planit Kombëtar për Zhvillim. Prej 175 aktiviteteve të parapara që të përfundojnë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, janë përfunduar vetëm 60 prej tyre

“Epoka e re”

PRISHTINË, 22 GUSHT - Lëvizja Fol ka publikuar të martën të dhënat nga monitorimi i Planit Vjetor të Punës së qeverisë, tashmë të quajtur Plani Kombëtar për Zhvillim. Mexhide Demolli-Nimani, drejtoreshë e Lëvizjes Fol, tha se para se ta paraqesin realizimin e aktiviteteve për secilën ministri, do të paraqesin disa të dhëna sa i përket përmbajtjes së këtij plani. “Plani Kombëtar për Zhvillim është përpjekja e tretë e qeverisë Kurti 2 për planifikimin operacional të punës së saj, duke ndërruar formën e planifikimit për secilin vit që nga ardhja në pushtet”, tha ajo, duke shtuar se pikërisht për këtë kanë bërë edhe një analizë të shkurtër të këtij plani. Ajo ka treguar se një nga të metat e mëdha të këtij lloji të planifikimit është vështirësia e zyrtarëve publikë për planifikim të mirëfilltë dhe kuptim të PKZh-së, e cila përsëritet për çdo vit.

Sipas saj, Lëvizja Fol ka identifikuar këto të gjetura kryesore. “Elementet kryesore të Planit Kombëtar për Zhvillim (tani e tutje: PKZh) janë: qëllimet zhvillimore dhe strategjike të shoqëruar me tregues të ndikimit dhe tregues kryesorë të rezultateve, masat strategjike të shoqëruara me tregues të rezultateve, veprimet e shoqëruara me tregues të produkteve, peshimi i masave strategjike dhe veprimeve, afatet kohore, buxheti dhe elemente të tjera më pak të rëndësishme. Plani ka një logjikë rrjedhëse, mirëpo pas analizimit të të njëjtës, vërehet se në fakt planifikimi operacional ka mangësi të

tepërta të cilat e bëjnë planin të palexueshëm, të pakuptueshëm dhe që nuk tregon asgjë apo edhe e fsheh zbatimin e vërtetë të PKZh-së. Aktivitetet e parapara në PKZh nuk korrespondojnë me Programin Legjislativ për vitin 2023”, ka thënë ajo, duke shtuar se masat strategjike të PKZh-së janë intervenimet të cilat ndërmerren për një periudhë trevjeçare, të cilat shoqërohen me tregues, veprime dhe buxhet përkatës. “Sidoqoftë, hartimi i masave nga ana e ministrive nuk ka uniformitet. Mungesa e uniformitetit vërehet në nivelin e masës: në disa raste janë jashtëzakonisht specifike, ndërsa në disa raste të tjera janë pothuajse të barasvlershme si vetë qëllimi strategjik. E njëjta vlen edhe për nivelin e treguesve. Edhe pse për masa strategjike është dashur të caktohen tregues të rezultateve, ato janë përzier me tregues të produkteve, në raste të caktuara edhe me ato të ndikimit. Po ashtu, në shumë raste buxheti mungon dhe nuk dihet se sa shpenzohet për një



masë të caktuar për arritjen e treguesve të vendosur. Një nga shkaqet për këtë është mungesa e kapaciteteve analitike për lidhjen e buxhetit dhe shpenzimeve me procesin dhe rezultatet e synuara”, ka thënë Demolli-Nimani. Ajo ka thënë se e metë tjetër e planit është mungesa e komunikimit të masave strategjike me qëllimet strategjike apo me treguesit e vendosur në qëllimet strategjike. “Peshimi është zbulimi i ri i qeverisë në

planifikimin operacional, për të cilin nuk ka informacione dhe nuk ka ndonjë shpjegim se pse bëhet apo si kalkulohet. Në këtë plan ne kemi dy raste kur bëhet peshimi: një të masat strategjike dhe një të aktivitetet”, është shprehur Demolli-Nimani. Ndërkaq Albana Hasani, hulumtuuese e lartë në Lëvizjen Fol, ka paraqitur realizimin e aktiviteteve për secilën ministri të parapara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 nga ana e dikastereve të qeverisë.

MASHTI, prej 10 aktiviteteve të parapara që të përfundojnë në tremujorin e dytë të vitit 2023, 4 prej tyre nuk janë përfunduar. ZKM ka planifikuar 47 aktivitete që të përfundohen deri në fund të tremujorit të dytë, ndërkaq ka realizuar vetëm 12 prej tyre. MPBZHR-ja ka planifikuar të realizojë pesë aktivitete nga të cilat i ka përfunduar të gjitha. MSh-ja ka planifikuar 14 aktivitete, prej të cilave i ka realizuar vetëm tetë. MKK ka paraparë vetëm një dhe atë e ka realizuar. MZHR-ja ka paraparë vetëm një dhe atë e ka realizuar. MM-ja ka paraparë vetëm dy aktivitete, prej të cilave vetëm

një është realizuar. MAPL-ja ka planifikuar vetëm katër aktivitete, ka realizuar tri dhe një nuk e ka realizuar. MD ka planifikuar 14 aktivitete brenda gjashtëmujorit të parë. Prej tyre, pesë janë përfunduar, gjashtë nuk janë përfunduar, ndërkaq për dy të tjera nuk ka ofruar përgjigje. MPB ka planifikuar 16 aktivitete, prej të cilave ka realizuar vetëm dy. MFPT ka planifikuar tetë aktivitete, prej të cilave i ka përfunduar gjashtë. MINT ka paraparë 18 aktivitete, prej të cilave shtatë i ka përfunduar, 10 nuk i ka përfunduar dhe për një nuk kanë ofruar përgjigje. ME ka planifikuar pesë aktivitete, prej të cilave ka përfunduar tre, ndërkaq dy nuk janë realizuar në afatin e paraparë. Ndërkaq MMPHI-ja dhe MKRS-ja nuk kanë kthyer përgjigje për realizimin e aktiviteteve të parapara. Në tërësi, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 në Planin Kombëtar për Zhvillim është paraparë realizimi i 175 aktiviteteve, prej të cilave kanë arritur të realizohen vetëm 60 nga to brenda afatit të paraparë.

Konkluzionet e Lëvizjes Fol

- Planifikimi i punës së Qeverisë është i palexueshëm, i palexueshëm dhe metodologjia e përdorur nuk tregon zbatimin e vërtetë, madje në disa raste e fsheh zbatimin e ulët.
- Metodologjinë e planifikimit të punës së Qeverisë nuk e kuptojnë as vetë zyrtarët publikë të cilët e hartojnë PKZH-në.
- Aktivitetet e parapara në PKZh nuk korrespondojnë me Programin Legjislativ për vitin 2023.
- Qëllimet, masat, veprimet, peshimi dhe buxheti janë të ndërlukuara, të përziera, jo uniforme dhe mungojnë në shumë raste.
- Elementet e PKZH-së nuk komunikojnë njëra me tjetrën: masat strategjike apo veprimet e propozuara nuk ndikojnë në arritjen e rezultateve të caktuara.
- Afatet kohore janë të vendosura në atë mënyrë që mund të interpretohen edhe si nisje edhe si mbarim, kur për këto vendosen statistika, gjë që fsheh mungesën e zbatimit apo zbatimin e ulët.

Dogana arrin edhe një rekord në të hyra, mbledh 1 miliard euro

Prishtinë 22 gusht- Dogana e Kosovës deri më sot ka arritur të mbledh 1 miliard euro, duke tejkaluar vitin e kaluar me 71 milionë euro apo 7.62 për qind. “Duke ditur se edhe viti i kaluar ka pasur trend shumë pozitiv të rritjes dhe njëkohësisht është rritur efekti kundërveprues i thellimit të shkallëve të mar-

rëveshjeve të tregtisë së lirë e në anën tjetër nuk ka ndryshim në politika fiskale, tejkalimi me këtë krahasim dëshmon qartazi vijimësinë e përkushtimit të pashembullt të Doganës së Kosovës në luftimin e ekonomisë jo formale dhe promovimin e praktikave që përkrahin konkurrencën fer dhe të

ndershme. Suksese të theksuara në këto përpjekje janë rezultat edhe i bashkëpunimit me institucionet relevante, komunitetin e biznesit dhe publikun në përgjithësi, andaj ju jemi shumë mirënjohës për përpjekjet e përbashkëta që kanë rezultuar me këto suksese”, ka njoftuar Dogana e Kosovës.



Bill Gates, sekretet e suksesit



Nga Rainer ZITELMANN

Unë e kam ndjekur jetën e Bill Gejtsit në dekadat e fundit. Në vitin 1992, si drejtor i "Ullstein Verlag", botova biografinë e parë të miliarderit amerikan në Gjermani. Autorët e librit ishin Xhejms Uollas dhe Xhim Erikson, dhe në atë kohë vështirë se dikush në Gjermani kishte dëgjuar për Bill Gejstin.

Prandaj, vendosa që t'i vendos titullin "Zoti Microsoft". Tek e fundit, njerëzit e njohin emrin e kompanisë dhe jo njeriun që e drejtonte atë. Ndërkohë sot gati të gjithë kanë dëgjuar ndoshta për Bill Gejts.

Në fillim të korrikut 1991, Bill Gejts Senior (Plaku) kishte disa të ftuar për darkë në shtëpinë e tij. Midis tyre ishte djali i tij, themeluesi i kompanisë "Microsoft", dhe Uorren Bafet – dy nga burrat më të suksesshëm në botë, të cilët për shumë vite kanë alternuar njëri-tjetrin në krye të listës së miliarderëve të revistës "Forbes".

Në një moment i zoti i shtëpisë i pyeti mysafirët e tij: "Cili është sekretet i suksesit tuaj?". Bafet u përgjigj menjëherë: "Përqendrimi!". Bill Gejts Xhuniore dha të njëjtën përgjigje.

Qëkur ishte i ri, Bill Gejts nuk ishte një person i lehtë për t'u menaxhuar.

Ai shkonte shumë mirë me mësimet në shkollë, sidomos në matematikë, por ishte i njohur për sjelljen e tij "të ashpër dhe sfiduese" ndaj mësuesve të tij. Për shembull, në shkollën e mesme ai pati një debat të fortë me mësuesin e tij të fizikës. Gejts po ngrinte zërin në kupë të qiellit, duke tundur gishtin dhe duke i thënë mësuesit të tij se e kishte gabim për një problem të

fizikës dhe nxënësi po e fitonte debatin me mësuesin.

Fiksimi i Billit pas kompjuterëve filloi që në moshën 13 vjeçare. Aq sa prindërit e tij ishin të shqetësuar për të. Edhe pse ishte vetëm në vitin e parë të gjimnazit, ai tashmë dukej i fiksuar pas kompjuterëve, duke injoruar gjithçka tjetër. Në këto kushte ata e ndaluan të prekte kompjuterin për 9 muaj.

Përplasjet e vazhdueshme të Bill Gejts me prindërit e tij arritën kulmin kur ai vendosi të braktiste Universitetin e Harvardit. Bill u tha prindërve se kishte shkuar në Harvard me shpresën se atje do të takonte njerëz me nivel intelektual më të lartë se ai, por nuk kishte gjetur dot të tillë.

Prandaj ai vendosi mirë të transferohej në Albuquerk në Nju Meksiko, për të themeluar kompaninë e tij. Prindërit e tij u përpoqën shumë që ta bindnin të hiqte dorë nga kjo ide që për ta ishte absurde. Ata i kërkuan një biznesmeni të suksesshëm dhe njëherazi mik i familjes, që të bisedonte me djalin e tyre, për ta rikthyer më këmbë në tokë.

Gjatë takimit mes të dyve, Gejts i tregoi biznesmenit planet e tij dhe i foli gjerë e gjatë për revolucionin në informatikë, për të cilin ai mendonte se ishte shumë pranë. Një ditë të gjithë do të kenë një kompjuter personal në shtëpi, i tha Gejts.

Pasi e dëgjoi biznesmeni që duhej ta bindte Billin të hiqte dorë nga planet e tij, përfundoi duke e mbështetur atë. Prindërit e tij u tronditën kur ai u largua nga universiteti për të themeluar "Microsoft", kompaninë që do ta bënte atë njeriun më të pasur në botë.

Sipas shokut të tij të dhomës në

universitet "Bill kishte një cilësi të rrallë. Ai përqendrohej tek diçka dhe bëhej plotësisht i lidhur me të. Ai kishte vendosmërinë të zotëronte çdo gjë që bënte". Edhe një nga ish-të dashurat e Gejts ka folur për fokusin e tij të vazhdueshëm tek objektivat dhe urrejtjen që kishte ndaj gjërave që e shpërqendronin.

Ai nuk kishte televizor në shtëpi, madje kishte hequr edhe kasetofonin e makinës: "Tek e fundit, ishte shumë e vështirë të mbaje një marrëdhënie me dikë me të cilin mund të kaloje vetëm një kohë të shkurtër, nga momenti i largimit nga zyra në "Microsoft" deri në atë të rikthimit në punë mëngjesin tjetër ish-in vetëm 7 orë" - kujton njëra prej tyre.

Ndërkohë Gejts ishte një shef i ashpër, një tipar karakterial që ai e ndan me shumë njerëz të suksesshëm. Në shumë aspekte ai ishte tërësisht e kundërta e drejtuesve për të cilët flitej në librat që jepnin leksione mbi leadershipin. Ai ishte i njohur për dërgimin e-maileve punonjësve të tij edhe në mes të natës (më shpesh kur ata ishin ende në punë).

Një e-mail tipik i tij fillonte kështu: "Kjo është pjesa më idiote e kodit e shkruar ndonjëherë". Punonjësit e tij u referoheshin këtyre mesazheve si "e-maile të zjarrtë". Ashtu si shumë shefa, Gejts ishte shpesh i paduruar, dhe e shprehte shpeshherë këtë gjë në mënyra që të tjerët i konsideronin fyese.

Një ish-menaxher i "Microsoft", kujton se Gejts i shkoi në zyrë që javën e tij të parë në kompani dhe i ulëriti "Si mund të harxhosh kaq kohë duke punuar mbi këtë kontratë? Vetëm bëje!". Ndërsa nuk ishte aspak e lehtë për t'u marrë

vesh me të, punonjësit e tij e vlerësonin faktin që Gejts ishte gjithnjë i vetëdijshëm për punën që po bënin.

Siç vuri në dukje një ish-punonjës: "Shumë njerëz nuk e pëlqejnë punën që bëjnë, pasi nuk marrin asnjë reagim pozitiv apo vlerësim. Ky problem nuk ekzistonte këtu. Ti e dije saktësisht se çfarë mendonte Billi për punën që po bëje". Sigurisht, anekdotat për karakterin nevrastenik të Gejts tregojnë vetëm njërin anë të historisë.

Ai e dinte më mirë se sa çdo sipërmarrës tjetër se si ta stimulonte dhe motivonte stafin e tij, për të arritur një qëllim të përbashkët. Askush nuk mund të arrijë një ecuri kaq të shkëlqyer nga punonjësit vetëm duke u bërë presion atyre. Edhe pse Gejts ishte i njohur për qëndrimin e tij agresiv ndaj të tjerëve, ai dinte t'i inkurajonte bashkëpunëtorët e tij, duke u dhënë atyre shumë liri krijuese.

Fryma pioniere dhe gjallëria frymëzuese e "Microsoft", kanë tërhequr shumë të rinj të zgjuar dhe ambiciozë. Pasi i ka arritur të gjitha me kompaninë e tij, Billi i ka vendosur vetes synime të reja dhe më të mëdha. Ai ka dashur gjithmonë që t'andryshojë për mirë botën, duke iu përkushtuar luftës kundër sëmundjeve.

Në vitin 1994 ai krijoi një fondacion, i cilinë vitin 1999 mori emrin Fondacioni Bill & Melinda Gejst. Ai është fondacioni më i madh privat në botë, me një aset prej afro 50 miliardë dollarësh. Që nga fillimi i këtij fondacioni, çifti Gejts ka shpenzuar gati 55 miliardë dollarë për bamirësi.

Projektet e fondacionit kryesisht kanë në fokus vendet në zhvillim,

ku ai po mbështet përpjekjet për të luftuar sëmundje të tilla si malaria dhe poliomieli. Në qershor të vitit 2010 Bill Gejts ndërmoi fushatën "Giving Pledge", së bashku me njerëz të tjerë, përfshirë mikun e tij Uorren Bafet.

Miliarderët që e mbështetën atë nismë kanë premtuar të dhurojnë të paktën gjysmën e pasurisë së tyre për bamirësi. Gejts është vendosur në qendër të shënjestrës së teoricienëve të konspiracionit, të cilët vënë në pikëpyetje gjithçka që ai bën, dhe madje e fajësojnë atë si sponsorin më të madh privat të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Pesë vjet para shpërthimit të Covid-19, ai bëri një paralajmërim të qartë: një virus shumë infektues mund të vriste një numër të madh njerëzish në të ardhmen e afërt. Kritikët e tij i kanë shtrembëruar këto fjalë kundër tij, duke e akuzuar atë për përhapjen e koronavirusit nëpër botë, në mënyrë që të ishte në gjendje të vaksinonte njerëzit dhe të fuste fshehurazi çipa në trupat e tyre për t'i kontrolluar.

Melinda dhe Bill Gejts kanë vendosur t'i japin fund martesës së tyre 27 vjeçare. Ata u njohën për herë të parë në parkingun e kompanisë "Microsoft" në vitin 1987. Gejts se pyeti nëse donte të dilte me të. Ajo refuzoi. Një ose dy orë më vonë, Bill i telefonoi dhe itha se kishte prenotuar një darkë diku po atë mbrëmje.

Shtatë vjet më vonë ata u martuan dhe patën tre fëmijë. Bill dhe Melinda Gejts nuk kanë nënshkruar një marrëveshje paramartesore, pavarësisht pasurisë së madhe. Por ata kanë një marrëveshje për ndarjen e pasurisë, kushtet e së cilës janë sekrete. / "Linkiesta" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT



Kafexholli paraqitet në Superkupën e Zvicrës

PRISHTINË, 22 GUSHT - Portierja e Përfaqësueses së Kosovës, Venera Kafexholli, ka bërë hap të rëndësishëm

në karrierë. Ajo të dielën u paraqit për ekipin e parë të klubit të njohur zviceran Spono Eagles. Spono luajti

në ndeshjen për Superkupë të Zvicrës. Pësoi nga LC Bruehl me rezultat 33:24. Kafexholli pritet të ketë

paraqitje të tjera për Spono Eagles, që do t'i shërbejnë për zhvillim të mëtejshëm në karrierë.



Drilon Hazrollaj, 'Ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 22 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, edhe këtë edicion vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për xhiron e 2-të të Albi Mall Superligës i ka takuar sulmuesit anësor të KF Malisheva, Drilon Hazrollaj. Komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje të Berat Berisha, Isuf Llumnica dhe Rifat Nasufi vendosi që epiteti i më të mirit për këtë xhiro t'i takojë sulmuesit anësor të skuadrës malishevase, pasi në ndeshjen kundër Fushë-Kosovës ai pati një paraqitje brilante, duke shënuar tre gola dhe duke asistuar në një tjetër gol. Tre golat e Hazrollajt janë të parët në këtë kampionat, ndërsa me këtë fitore FC Malisheva arkëtoi tri pikë të reja duke qenë, pas dy xhirove, lidere në Albi Mall Superligë edicioni 2023/24. Pasi mori këtë çmim,



Hazrollaj u shpreh i lumtur që skuadra e tij e nisi mbarë edicionin e ri në elitën e futbollit në Kosovë. "Çmimi 'Ylli i javës' është i pari për mua dhe sinçerisht jam shumë i lumtur. Kur shpërblehesh si më i miri i xhiros shtohet edhe motivi për punë. Falënderoj bashkëlojtarët

dhe shtabin teknik të cilët më ndihmuan që të kem një performancë të tillë dhe ta fitoj këtë çmim. E kemi filluar kampionatin mbarë dhe uroj që të vazhdojmë këtë ecuri pozitive edhe në xhirot e ardhshme", ka thënë Drilon Hazrollaj për faqen zyrtare të FFK-së.



Shtyhet ndeshja Drita - Ballkani

PRISHTINË, 22 GUSHT - Derbi i javës së tretë në Superligën e Kosovës në mes të Dritës dhe Ballkanit nuk do të zhvillohet këtë fundjavë ani pse ishte paraparë që kjo ndeshje të zhvillohej të dielën e 27 majit. Ballkani ka bërë kërkesë në FFK që kjo ndeshje të shtyhet për shkak të ndeshjeve evropiane dhe Komisioni i Garave e ka aprovuar kërkesën e tij. "Komisioni i Garave e ka aprovuar kërkesën e FC Ballkani, që ndeshjen e javës së 3-të të Albi Mall Superligës, ndërmjet FC Drita - FC Ballkani, e cila ka qenë në program të zhvillohet



me datë 27.08.2023, ta shtyjë për një datë tjetër, për arsye të interesit të futbollit të Kosovës, ngaqë FC Ballkani më 24 dhe 31 gusht i zhvillon ndeshjet e

rëndësishme të 'play-off' -it kundër Bate Borisovit për kualifikime në fazën e grupeve në UEFA Conference League", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Vojvoda: Jam mirë në Torino

TORINO, 22 GUSHT - Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Mërgim Vojvoda, po synohet nga shumë klube evropiane. Mediet italiane kanë raportuar se interesim kanë shprehur dy klubet ruse, Lokomotivë Moska dhe Spartak Moska. Interesim ka treguar edhe Udinese. "Unë jam mirë në Torino dhe ndihem gjithmonë e më mirë. Me trajnerin Juriq kam mësuar dhe gjithmonë ka shkuar gjithçka

mirë", ka thënë Vojvoda pas ndeshjes me Cagliari. "Cagliari e bëri një lojë të ngjeshur, sidomos prapa, që ishte vështirë të depërtonim. I krijuam disa raste dhe na mungoi veç goli. Ne e dinim se ata do të vendoseshin kështu në fushë, prandaj edhe nuk prisnim se do të fitonim 5:0. Provuam të gjuanim edhe nga distanca, por nuk shkoi mirë", ka shtuar Vojvoda.



Beshiktashi: Nuk arritëm marrëveshje me Ramosin për çështje financiare

STAMBOLL, 22 GUSHT - Skuadra e Beshiktashit ka bërë me dije se ka pasur kontakte me futbollistët, por janë ndërprerë për shkak të mosmarrëveshjeve për çështje financiare. "Në agjendën e transferimeve të klubit tonë ishin edhe futbollistët e suksesshëm

Sergio Ramos dhe Anderson Talisca, të cilët me cilësitë e tyre zënë një vend të rëndësishëm në tregun botëror të futbollit, të cilat çdo klub, çdo president dhe çdo trajner do të dëshironin t'i shihet në staf. Në këtë drejtim patëm kontakte me Talisca dhe klubin e tij dhe

negociata me Ramosin, të cilat u zhvilluan duke pasur parasysh interesat e klubit tonë, por u ndërpreu për shkak të mosmarrëveshjeve për çështje financiare. Me respekt i paraqesim informacionet e publikut dhe fansave tanë", thuhet në njoftimin e Beshiktashit.

Arteta: Më pëlqen kur fitojmë me 10 lojtarë

LONDËR, 22 GUSHT - Arsenali vuajti shumë në ndeshjen ndaj Crystal Palace, por mori tri pikët e plota (0-1). "Topçinjtë" i përgjigjen Brightonit dhe Man. Cityt, tri ekipet e vetme me 6

pikë në 2 javët e para të Premierë Ligës. Arsenali e realizoi golin e vetëm në pjesën e dytë, kur Odegaard u tregua i saktë nga pika e bardhë e penalltisë. Londinezët ngejnë

me 10 lojtarë pas minutës së 67, detaj që nuk ndikoi në rezultatin final, me "topçinjtë" që festojnë për këtë trespikësh. Mikel Arteta, trajner i Arsenalit, shijon këtë fitore të ekipit: "Më pëlqen

jashtëzakonisht shumë kur fitojmë në këtë mënyrë, me 10 lojtarë. Nuk lejuan kundërshtarit të afrohej në zonë, të na vendoste fitoren në rrezik".



Alonso: Ndiej keqardhje që nuk e kam fituar titullin në vitet 2010 e 2012

MADRID, 22 GUSHT - Një piloti si Fernando Alonso nuk i pëlqen aspak fjala "keqardhje", por vetë kampioni i botës në Formula 1 pranon se fakti që nuk fitoi titullin kur ishte me Ferrarin është një keqardhje për të. Në vitet 2010 e 2012 atij i iku titulli nga duart në garën e fundit, dy zhgënjime që ai i ndien ende edhe sot. "Nëse do të kthehesha pas në kohë do të ndryshoja diçka. Gjëja e parë që do të ndryshoja është të fitoja një titull kampion me Ferrarin. Në vitet 2010 e 2012 ishim pak xhiro larg fitores së kampionatit dhe kjo mund ta kishte ndryshuar historinë e disa gjërave. Më ka ardhur keq që kam humbur në ato raste", ka thënë Alonso. "Por të ndryshosh këtë gjë është e pamundur, pasi varet nga shumë persona, nga skuadrat e tjera, makinat. Është e vështirë të ndiesh keqardhje për diçka që është jashtë kontrollit tënd. E di



që jam në fund të karrierës, por kur kthej kokën pas shoh shumë gjëra të bukura, miqësi dhe përvoja të jashtëzakonshme. Do ta ndryshoja vetëm mënyrën se si kam jetuar disa momente të caktuara", është shprehur Alonso. "Nëse do të kthehesha pas do të shijoja disi më shumë momentet

e bukura. Kam fituar dy tituj në Brazil, 2005 e 2006, por thajse nuk mbaj mend asgjë nga ato pasdite e net dhe kjo është e trishtë. Ndaj shijoj shumë podiumet e këtij sezoni, pasi e shoh podiumin në një këndvështrim tjetër nga 20 vjet më parë", ka deklaruar Alonso.

NBA zyrtarizon nisjen e sezonit të ri, Lakersi sfidon kampionët në fuqi

LOS ANXELOS, 22 GUSHT - Sezoni i ri 2023-2024 në NBA do të nisë më 24 tetor, ditën e martë, ashtu si zakonisht. Ndeshja hapëse do të jetë ajo mes kampionëve në fuqi të Denver Nuggetsit dhe Lakersit, sfidë që do të zhvillohet në "Ball arena" të Denverit, ku para takimit do të zhvillohet edhe ceremonia e dorëzimit të unazave për kampionët e rinj. Këto dy skuadra luajtën vjet edhe në finalen e Konferencës së Perëndimit. Ndeshja tjetër që do të luhet më 24 tetor është ajo në mes të Golden State Warriorsit dhe Phoenix Sunsit, një tjetër përballje mjaft e fortë mes dy ekipesh kandidatë për titullin edhe këtë sezon të ri. Më 18 shkurt do të zhvillohet ndeshja magjike e "All Star Game", në Indianapolis, ndërkohë që sezoni i rregullt do të mbyllet më 14 prill. Më 16-19 prill luhen ndeshet "play-in" dhe më 20 prill nisi faza "play-off". Finalen për titullin do të nisin



më 6 qershor 2024. Më 15 janar, ditën e "Martin Luther King", do të luhen katër ndeshje "big":

Philadelphia-Houston, Atlanta-San Antonio, Memphis-Golden State dhe Lakers-Oklahoma.

SHKURT

Manaj paraqitet te Sivasspori

Rey Manaj është zyrtarisht futbollist i Sivassporit në Superligën e Turqisë. Lajmi është dhënë nga klubi në rrjetet sociale. Sulmuesi i kombëtares shqiptare është paraqitur sot te klubi turk. Ai ka zgjedhur ta shmangë gjuhën shqipe dhe të flasë spanjisht gjatë paraqitjes. Ai ka firmosur një kontratë trevjeçare me klubin i cili ka synim të kthehet përsëri në kompeticionet ndërkombëtare. Manaj është jashtë fushave të lojës që nga dhjetori i vitit të kaluar, kur një dëmtim e la atë përfundimisht jashtë planeve të Watfordit dhe mbylli para kohe aventurën e tij në kampionatin anglez.

Bonucci, afër kalimit tek Union Berlini

Leonardo Bonucci mund të transferohet tek Union Berlini. Mbrojtësi italian do të largohet nga Juventusit dhe po eksploron mundësi të ndryshme. Sipas Fabrizio Romano, ai është shumë afër firmës me klubin gjerman. Vendimi tani i takon lojtarit. Klubi është absolutisht në favor të nënshkrimit të tij dhe përgjigjja duhet të arrijë këtë javë. Në Itali, për Bonucci kishte pasur interesim konkret nga Lazio, i cili nuk gjeti gjuhën e përbashkët me klubin kryeqytetas. Epoka e tij me Juventusin është pranë përfundimit, pas 502 ndeshjeve dhe 35 golave me fanellën bardhezi.

Edhe Salahu mund të transferohet në Arabi

Sulmuesi egjiptian, Mohamed Salah mund të largohet nga skuadra e Liverpoolit pas shtatë vjetëve për ta vazhduar karrierën në Arabinë Saudite. Sipas raportimeve të fundit, aventura e Salah në "Anfield" mund të përfundojë këtë verë. Skuadra e Al-Ittihad thuhet se është duke përgatitur një ofertë të majme për sulmuesin egjiptian, duke ia ofruar një pagë prej 150 milionë eurove në sezon. Salah thuhet se është duke menduar ofertën dhe largimi i tij mund të jetë i mundur. Ai pritet të nënshkruajë një kontratë trevjeçare me sauditët. Al-Ittihad vetëm gjatë kësaj merkato ka transferuar Karim Benzemën, N'Golo Kane e Fabinhon. Liga e Arabisë Saudite po bëhet gjithnjë e më e ndjekur duke marrë parasysh transferimin e yjeve të futbollit evropian.

Henry emërohet zyrtarisht trajner i Francës U21

Ish-sulmuesi legjendar i Francës, Thierry Henry, ka marrë detyrën e tij të radhës si trajner me "Les Bleus". Henry do të shërbejë si trajner i ekipit francez U-21 deri në vitin 2025, sipas Federatës Franceze të Futbollit. Legjenda e Arsenalit do të punojë me ekipin përpara Lojërave Olimpikë në Paris verën e ardhshme. "Thierry Henry është emëruar trajneri i ri i Francës U21 deri në vitin 2025. Ish-reprezentuesi francez do të udhëheqë Les Bleuets gjatë fushatës së ardhshme kualifikuese për Euro 2025 U21, si dhe Lojërat Olimpikë në Paris në 2024", thuhet në njoftim. Ai zëvendëson Sylvain Ripoll, i cili humbi punën e tij pas eliminimit të hershëm të kombëtares në Euro U-21 këtë verë. Henry ka punuar në Monaco në Ligën 1 dhe Montreal në MLS, ndërsa ai ishte asistent i Robert Martinezit për një kohë të gjatë te Belgjika. Futbollisti i madh do të debutojë me të rinjtë e Les Bleus më 7 shtator kundër Danimarkës.

Mattheus: Beckenbaueri nuk është mirë me shëndet

Të tjera shqetësime për shëndetin e 'Kaiserit', Franz Beckenbauer. Gjatë një ngjarjeje të organizuar nga Interwetten, lojtarit rekordmen i kombëtares gjermane, Lothar Mattheus, foli për mikun e tij prej shumë

vitesh. "I urojmë shëndet të mirë, që të jetë sërish vetvetja, me energjinë e tij. Sigurisht që urojmë që ai të përmirësohet. Franz gjithmonë thoshte se shëndeti është gjëja më e rëndësishme në jetë. Ai nuk

është mirë për momentin. Nuk po ecën mirë me shëndetin. Kjo është arsyeja pse nuk ishte në takimin për Kupën e Botës para 4 ose 5 javësh. Sigurisht që shpresojmë që gjërat të shkojnë në drejtimin tjetër", ka shtuar

Mattheus. Në fillim të korrikut kampionët e botës nga viti 1990 u mblodhën të gjithë në hotelin luksoz "Das Achenal" në Bavari, 33 vjet pas triumfit të madh. Por mungonte personi më i rëndësishëm,

Beckenbauer, menaxheri i ekipit që shkëlqeu në atë kohë. Gruaja e tij, Heidi, ka deklaruar: "Fatkeqësisht Franz nuk mund të jetë atje për arsye shëndetësore. Do të ishte thjesht e tepërt për të".



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 11-23

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit të cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10 000 Prishtinë**, apo përmes emailit: **info@omk-rks.org**, me titullin:

Dosja për: Kontratë për akomodimin e të ftuarve në Ceremoninë e shënimit të 10 vjetorit të themelimit të Odës së Mjekëve

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 2 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashkrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 8 (tetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashkrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **25.08.2023 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **28.08.2023 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **28.08.2023 ora 14:00.**



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 22.08.2023
008/2023

Referenca: AAPSK –

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Furgon Mercedes Benz-MB 100D, dizel, ngjyre e bardhë-për pjesë	1 copë/për pjesë	300.00€		
2	VW Golf II 19E viti i prodhimit 1986,benzinë, ngjyre e kuqe-për skrap	1 copë/për skrap	201.94€		
3	VW Golf II 19E,viti i prodhimit 1988, benzinë, ngjyre e zeze-për skrap	1 copë/për skrap	208.84€		
4	Audi 80, viti i prodhimit 1987,benzin, ngjyrë e kaltër metalike-për skrap	1 copë/për skrap	234.60€		
5	Mercedes 190, viti i prodhimit 1986, Benzinë ngjyrë e hirit metalike- për skrap	1 copë/për skrap	269.10€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më **29.08.2023** në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin nga **pika 1 deri në pikën 4** mund ta shikojnë me datë: **28.08.2023**, prej orës 10:00-11:00 në hapësirat e **Qendrës Korrektuese në Smrekonicë**, kurse mallin në **pika 5** ,me datën **29.08.2023**, prej orës 10:30-11:00 në **Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë**.

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aaprk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 258

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.385/17

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Jeton Zymeri, në çështjen juridike të paditësit Nexhat Musliu nga fshati lum i Madh, komuna e Vushtrrisë, të cilin e përfaqëson me autorizim Ferat Musliu nga fshati lum i Madh, komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurve Milen Lubomir Trifunoviq dhe Gvozden Petara Trifunoviq që të dy nga fshati Lum i Madh, komuna e Vushtrrisë, tani me adresë të panjohur, me objekt kontesti vërtetim i shitëblerjes, jashtë seance me datë 27.10.2022 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Të paditurve Milen Lubomir Trifunoviq dhe Gvozden Petara Trifunoviq, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Av.Ruzhdi Maloku nga Vushtrria.

II. Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA NE VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.385/17, datë 27.10.2022



Gjyqtari
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dion Milla nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Mazllom Këpuska".

- Arton Lubishtani B.I, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 810647802.

- "INNO HOME" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811875840.

- Albina Bucolli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. 1-9 të shkollës "Fazli Grajqevci" Poklek Vasilev komuna e Drenasit.

- Alban Bucolli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. 1-9 të shkollës "Fazli Grajqevci" Poklek Vasilev komuna e Drenasit.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

